



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2658 / prot.  
2

Tiranë, më 27.09.2022

VENDIM

Nr. 56, datë 27.09.2022

**“PËR NJË KORRIGJIM GABIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR.6 DATË 26.01.2022 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE ME NOTË MESATARE 9-10, QË PËRFITOJNË BURSË, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 DHE STUDIOJNË NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË PARË DHE PROGRAM STUDIMI TË INTEGRUAR, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, SIPAS LISTAVE TË QSHA-së” ”**

Në bazë të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave VKM nr.903, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të UMT-së nr.1423/1 prot., datë 29.06.2022, “Kërkese për një ndryshim në vendimet e bordit nr.6 dhe 8 datë 26.01.2022”, në mbledhjen e datës 27.09.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë korrigjimin e gabimit në vendimin nr.6 datë 26.01.2022 me objekt “Për miratimin e listës së studentëve me notë mesatare 9-10, që përfitojnë bursë, për vitin akademik 2021-2022 dhe studiojnë në një program studimi të ciklit të parë dhe program studimi të integruar, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, sipas listave të QSHA-së”, duke korrigjuar gabimin e emrit të studentit Desara Almir Hyka me emrin e studentit Desara Ferdinant Hysko.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETAR  
ZAMIRA GJINI

ANËTARE

MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ENDRIT YZEIRAJ

Ki  
Pr